



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 28

Prishtinë, më 29 nëntor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Behar Selimi, Haki Demolli, Arsim Bajrami, Armend Zemaj, Amir Ahmeti dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Mufera Šinik, Halit Krasniqi, Albulena Haxhiu dhe Ardian Gjini.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati – ZPRK, Artan Canhasi – EULEX, Floriana Shala - OSBE, Astrit Hoti – KGJK, Natyra Krasniqi – KDI, Florie Mehmeti – KDI, Arbane Shala Rama – studente, Sylë Ahmeti – Kosova sot dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.09.2011;
3. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
4. Shqyrtimi në parim i Projektkodit penal të Republikës së Kosovës;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-68 për Qeverinë e Republikës së Kosovës;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L- 54 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të tyre;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-69 për të huajt;
8. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-73 për Azilin;
9. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funksional në Projektligjin nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave;

10. Shqyrtimi i kërkesës së Kryqit të Kuq i Kosovës, nr. 03 / 101 i datës 11.11.2011;
11. Shqyrtimi i kërkesës së organizatës “ÇOHU”;
12. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që pika e gjashtë dhe e nëntë të hiqet nga rendi ditës.

Rendi ditës u miratua me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 26.09.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes 26.09.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i propozimeve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kryetari- Paraqiti për shqyrtim propozimet për anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ramie Rama Elezi, propozuar nga G 6+, Nebojsa Boriqiq nga komuniteti serb dhe Salih Mekaj, ku me këto propozime përmbyllet një situatë e tejzgjatur lidhur me përbërjen e Këshillit.

Arsim Bajrami- Propozoi që kandidatët e pakicave t'i kalojmë, ndërsa kandidatin tjetër ta diskutojmë edhe pak, sepse nuk po dihet se kush është propozuesi eventualisht të shohim a mos kemi edhe kandidatë tjerë.

Kryetari- Propozoi që t'i kalojmë në paketë sepse na jep komplikime edhe në seancë.

Behar Selimi- U pajtua me propozimin e Arsim Bajramit sepse është mirë të dihet se kush është propozuesi.

Armend Zemaj- Unë vetëm për shkak të procedurave se me të vërtetë e kemi stërgjatë, jo ndoshta krejt edhe me fajin tonë, andaj unë jam që të shkojnë këta tre emra, duke përfshirë edhe gjyqtarin Salih Mekaj, mendoj që nuk kemi çka të zvarrisim më tepër.

Kryetari- Herën e kaluar kur e kemi diskutuar të njëjtin emër, i vetmi shqetësim ka qenë i Halit Krasniqi, për këtë e kemi tërhequr prej rendit të ditës, ai nuk ka bërë ndonjë ndonjë propozim apo vërejtje.

Haki Demolli- Unë e shikova listën e të gjithë anëtarëve dhe nuk po shoh ndonjë mangësi dhe se të gjithë i plotësojnë kushtet që të jenë anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni u pajtua që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje të radhës.

4. Shqyrtimi në parim i Projektkodit penal të Republikës së Kosovës

Komisioni për Legjislacion, para shqyrtimit të parë të Projektligjit në mbledhje plenare, për të vepruar në pajtim me Rregulloren e Kuvendit, e shqyrtoi në parim Projektligjin e theksuar, dhe vlerësoi se Projektligji ka bazë kushtetuese dhe i plotëson kushtet t'i procedohet Kuvendit për shqyrtimin e parë dhe për miratim në parim.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektkodi penal i Republikës së Kosovës, 04/L- 82

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për nr. 04/L-68 për Qeverinë e Republikës së Kosovës

Kryetari, paraqiti vërejtje në amendamentet 10 dhe 11 të propozuara në Projektligjin për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Amendamenti 10 i jep mundësinë Qeverisë që me vendim të bartë në Zyrën e Kryeministrit, ose në zyrat e ministrive përkatëse, agjencitë ekzekutive qeveritare, e që është në kundërshtim me ligjet për themelimin e këtyre agjencive. Ndërsa në amendamentin 11 fjalia “deri në masën që nuk janë në kundërshtim me këtë ligj” është e përgjithësuar dhe krijon zbrazëti, që rregulloret e përmendura të mos jenë të harmonizuara me këtë ligj.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nr. 04/L-68, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përveç amendamenteve 10 dhe 11.
3. Amendamenti 10, që i jep mundësinë Qeverisë, që me vendim të bartë në Zyrën e Kryeministrit, ose në zyrat e ministrive përkatëse, agjencitë ekzekutive qeveritare, e që është në kundërshtim me ligjet për themelimin e këtyre agjencive.
4. Amendamenti 11 nuk e ka qartësinë e duhur normative, sidomos fjalia “**deri në masën që nuk janë në kundërshtim me këtë ligj**” është e përgjithësuar dhe krijon zbrazëti që rregulloret e përmendura të mos jenë të harmonizuara me këtë ligj. I sugjerohet Komisionit FunkSIONAL ky riformulim: “**Rregullorja e punës së Qeverisë nr. 09/2011 dhe Rregullorja e Qeverisë nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrive, duhet të harmonizohen me këtë ligj në afat prej 6 muajsh, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.**”

5. Projektligji me amendamentet mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim, përveç amendamentit 10 dhe 11.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-69 për të huajt

Kryetari - E paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për të huajt dhe kërkoi nga anëtarët, që të deklarohen nëse ka vërejtje për amendamentet.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-69 për të huajt, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-73 për Azilin

Kryetari - E paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për Azilin dhe kërkoi nga anëtarët, që të deklarohen nëse ka vërejtje për amendamentet.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-73 për Azilin, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

8. Shqyrtimi i kërkesës së Kryqit të Kuq i Kosovës, nr. 03 / 101 i datës 11.11.2011

Komisioni e shqyrtoi kërkesën e Kryqit të Kuq i Kosovës, që ka të bëjë me nenin 14, paragrafi 1.7 të Ligjit nr. 03/L-179, lidhur me sigurimin e mjeteve financiare nga sigurimi i obligueshëm i automjeteve, 1% nga bruto primi i vlerës së sigurimit të automjetit. Komisioni konstatoi se kjo çështje nuk është në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion, prandaj kërkesa si e tillë, të procedohet në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për shqyrtim të mëtejme.

9. Shqyrtimi i kërkesës së organizatës “ÇOHU”

U shqyrtua kërkesa e organizatës , “Çohu”, dhe përgjigja do t’i përcillet organizatës lidhur me çështjet e ngritura.

10. Të ndryshme

Kryetari, ngriti çështjen e organizimit të një punëtorie të përbashkët me Komisionin e Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për Projektligjin për marrëdhëniet, por problemi është se me datën 8.12.2011, është seanca e Kuvendit. Po ashtu foli për skadimin dhe e njoftoi Komisionin se u ka skaduar mandatit anëtarëve të bordit të AKP-së, dhe ende nuk i kemi propozimet për anëtarë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisioni

Arben Gashi